



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr. 055/2020

Nr. Protokolli: 108/2020

Për:	N.SH. " Liriu ", Brig.123, 23000, SUHAREKË
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	25.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 19.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **N.SH. " Liriu ", Brig.123, 23000, SUHAREKË** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave"** me Nr. të Prokurimi: **624-20-2107-5-2-1& 624-020-025-521** nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e datës 19.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **N.SH. " Liriu ", Brig.123, 23000, SUHAREKË**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave"** me Nr. të Prokurimi: **624-20-2107-5-2-1& 624-020-025-521** Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës 14.09.2020 të publikuar në platformen elektronike.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 14.09.2020

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 19.09.2020, ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **"Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave"** me Nr. të Prokurimi: **624-20-2107-5-2-1& 624-020-025-521** kundër Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës 14.09.2020 të publikuar në platformen elektronike

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik gjatë vlerësimit të tenderëve, dhe se komisioni për vlerësim dhe krahasim të tenderëve ka vlerësuar drejt, konform Ligjit të Prokurimit Publik dhe RRUOPP duke analizuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar sipas DT.

Tenderi juau është refuzuar sipas njoftimit B58 të dates 14.09.2020 me faktin se ” Nga se ju nuk keni plotsuar kushtin administrativ, siç është kërkuar me dosje te tenderit dhe Njoftimit për kontratë (paramasa eshte e plotesuar me njesi, ndersa eshte kerkuar me sasi).”

Ilustrim: Kulona e pare e specifikimit teknik të prezantuar ne platformen elektronike- për ativitenin e prokurimit Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave.

SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL						
Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njesi pa TVSh	TVSH	Totali
1	Furnizimi me ngjyre dhe punimi i mbishkrimeve në rrugë si : STOP, SHKOLLA, BUS, TAXI, etj. Ngjyra duhet të jetë e plastifikuar me trashesi se paku 3 mm (e paisur me grimca të fosforit), e qëndrueshme ndaj temperaturave dhe kushteve tjera klimatike. Ngjyra përcakohet nga AK dhe duhet të ketë qëndrueshmëri së paku 18 muaj.	copë	10			

Ketu shihet qarte se është rubrika e Totalit, dhe e njejta duhet të plotesohet çmimi për sasi.

Po ashtu pretendimi juaj, se çmimi për njesi konsiderohet mbizotrues, kjo qëndron mirpo në rastin tuaj nëseKomisioni për vleresim dhe AK-Suharekë, pot ë niset nga ky fakt, që qmimin e ofruar për njesi të shëndrroj në qmim për sasi, atëheret tejkalohe vlera 2 % e lejimit të ndryshimit në paramas, me çka automatikisht refuzohet tenderi juaj.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shef i Prokurimit
Afim BYTYQI

